

18 Shkurt 2015, Prizren

THIRRJE PËR OFERTIM

Audio tour guides (ciceronë elektronik) dhe audio incizim i përmbajtjes

OJQ EC Ma Ndryshe me seli në Prizren ka nisur zbatimin e projektit “Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren”. Në kuadër të këtij projekti, do të hartohen: një katalog i trashëgimisë kulturore të rajonit Jug; dhe pesë guida/pako turistike të rajonit të Prizrenit. Të gjitha këto produkte do të hartohen në shtatë gjuhë të ndryshme (shqip, serbisht, turqish, anglisht, frengisht, gjermanisht dhe italisht). Pjesë e projektit është edhe blerja e një kompleti të audio tour guides/ciceronë elektronik (deri në 30 copë), dhe audio incizimi i përmbajtjes së katalogut të trashëgimisë kulturore në shtatë gjuhë. EC Ma Ndryshe do të përzgjedh një kompani profesionale për të ofruar këto shërbime (kompleti i audio tour guides dhe audio incizimi i përmbajtjes së katalogut), për çka ju ftojmë që të dërgoni ofertën tuaj bashkë me dokumentet përcjellëse.

Detyrat, përgjegjësitë dhe përshkrimi i produkteve

Kompania e përzgjedhur do të obligohet që të sigurojë kompletin e pajisjeve audio tour guides (ciceronë elektronik) dhe t’ia dorëzojë atë organizatës me të gjitha obligimet e kryera (përfshi ato të importit), bashkë me audio incizimin e përmbajtjes së katalogut në shtatë gjuhë të instaluar tek pajisjet (audio tour guides). Katalogu përmban monumente të trashëgimisë kulturore dhe natyrore ku secili monument ka tekstin e vet të shkurtër dhe numrin referent. Incizimi i audio materialeve duhet të bëhet me pajisje profesionale dhe të jetë i cilësisë së lartë.

Audio tour guides duhet t’i kenë edhe pajisjes përcjellëse (kofer, karrikues i baterive, manual/software i përdorimit, etj). Ato duhet të kenë mundësinë për së paku shtatë gjuhë dhe hapësirë të incizimit të audio materialeve deri në 2GB. Pajisjet audio tour guides duhet të kenë mundësinë e lëshimit, ndërrimit dhe ndalimit të audio materialeve në çdo kohë sipas nevojës, si dhe mundësinë e përzgjedhjes së materialit për të dëgjuar sipas dëshirës (gjuha, numri i monumentit).

Shërbimi nuk do të konsiderohet i përfunduar derisa të gjitha pajisjet të jenë në gjendje funksionale, me audio materialet e instaluar në shtatë gjuhë.

Kriteret e përzgjedhjes

Gjatë shqyrtimit të ofertave, EC Ma Ndryshe do të ketë për bazë këto kriteret të përzgjedhjes:

- Çmimi i volitshëm,
- Specifikacionet teknike të pajisjeve,
- Përvoja e kompanisë në tregun e pajisjeve elektronike (dëshmitë dokumentare),
- Afati i ofruar për dorëzimin e produkteve në gjendjen e kërkuar,
- Garancioni dhe mirëmbajtja e pajisjeve pas blerjes
- Referencat nga klientët (opsionale).

Aplikimi

Për të ofertuar për shërbime të audio tour guides (ciceronë elektronik) dhe audio incizimi i përmbajtjes së katalogut, ju lutem dërgoni ofertën tuaj financiare në email adresën info@ecmandryshe.org dhe shkruani në *subject* "Ofertë për shërbime të audio tour guides", më së largu deri më 25 Shkurt 2015, në orën 24.00. Aplikacionet që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen. Oferta duhet të përmbajë çmimin total të shërbimit, të zbërthyer në çmimin e kompletit të pajisjeve audio tour guides dhe çmimin e incizimit dhe instalimit të audio materialeve. Bashkë me ofertën tuaj financiare, ju lutem bashkëngjitni edhe këto dokumente: detaje mbi origjinën e pajisjeve, specifikacionet teknike të pajisjeve, certifikata e regjistrimit të biznesit, certifikata e numrit fiskal, certifikata e TVSh-së, dëshmi të shërbimeve të mëhershme (të ngjashme), afati për dorëzimin e produkteve në gjendjen e kërkuar dhe detaje mbi garancionin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve pas blerjes.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë nëse e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Për më shumë informacione rreth thirrje për aplikim, ju lutemi vizitoni www.ecmandryshe.org/konkurse.

Projekti "Mbështetje për sektorin e turizmit në Rajonin Ekonomik Jug", përkrahjet financiarisht nga Ministria për Punëve të Jashtme të Finlandës në suaza të projektit "Ndihmë Tregtisë", implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).